



**Procedura për ekzekutimin e çmimit më të mirë për klientin në zbatim të Ligjit nr. 62/2020 "Për Tregjet e Kapitalit"**

*\*Aneks i rregullores "Rregullore për Marrjen, Transmetim dhe Ekzekutimit të Urdhrave"*



## 1. Parimet bazë të veprimtarisë

Rregullorja për Marrje, Transmetim dhe Ekzekutim të Urdhërave për Llogari të klientëve dhe Tregtim për Llogari të vet është hartuar me qëllim të përcaktimit të rregullave, parimeve dhe procedurave që udhëheqin veprimtarinë e bankës në procesin e marrjes dhe transmetimit të urdhërave për llogari të klientëve në bazë të parimeve për ekzekutimin më të mirë. Ajo synon të sigurojë funksionimin e drejtë, transparent dhe në përputhje me kërkesat ligjore e rregullatore të Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

## 2. Rishikimi dhe Publikimi i Procedurës

Rregullorja miratohet nga Komiteti ALCO. Rregullorja do të rishikohet një herë në vit ose kur ka ndryshime të kuadrit rregullator.

Kjo procedurë do të publikohet dhe përditësohet pas çdo ndryshimi eventual në faqen e internetit të Bankës me fokus mbi procedurën e Ekzekutimit më të mirë dhe listën e vendeve të ekzekutimit (execution venues) direkte ose ato indirekte të ofruara nga kundër palët.

## 3. Përkufizime dhe Shkurtime

ALCO	Assets Liabilities Committee
KpK	Kerkese për Kuotim
MiFID II	Markets in Financial Instruments Directive 2014
AFISaR	Sistemi i shlyerjes dhe regjistrimit të titujve (Albanian Financial Instrument Settlement and Registration)
OTC	Over the counter (tregtim në degët e bankave)
AMF	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare
BSH	Banka e Shqipërisë

## 4. Shërbimet e ofruara dhe Tregjet ku vepron Union Bank

Union Bank do të ofrojë shërbimet e mëposhtme të investimeve për klientë privatë dhe klientë profesionistë:

- ✓ Tregtim për llogari të vet.
- ✓ Ekzekutimi i urdhërave në instrumente financiare për llogari të klientëve.
- ✓ Marrja dhe transmetimi i urdhërave në lidhje me një ose më shumë instrumente financiare.

Për të zbatuar parimin e ekzekutimit më të mirë Union Bank do të:

- ✓ Përcaktojë tregjet ku do të veprojë për ekzekutimin e urdhërave për shitblerje titujsh për llogari të klientëve.
- ✓ Përcaktojë kundër palët, me të cilat do të veprojë për marrjen dhe transmetimin e urdhërave në bazë të përzgjedhjes së tyre sipas përputhshmërisë MiFID II.

Tregjet ku do të veprojë direkt Union Bank janë:

-Tregu OTC ndër bankar

### Lidhur me Tregtimin për llogari të vet

- a) Publikon listën dhe karakteristikat e titujve të përfshirë në portofolet e vlefshëm për shitje (AFS); kuoton çmimet e tyre bazuar në metodologjitë e brendshme të miratuara në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare dhe tiparet dhe praktikatat e tregut shqiptar.
- b) Negocion me klientët dhe finalizon transaksione shitblerje të titujve respektivisht nga dhe tek portofoli i titujve në pronësi të saj.

#### - Lidhur me marrjen dhe transmetimin e urdhrave të klientëve:

- a) Merr nga klienti urdhërat dhe transmeton tek kundër palët (palët e treta), në varësi të tipologjisë së titujve, në tregun OTC ose tregje të tjera të rregulluara duke u siguruar që kundër palët të ofrojnë këtë shërbim sipas praktikave më të mira bazuar në parimin e ekzekutimit më të mirë;
- b) Kryen dhe mbikëqyr përshtatshmërinë e klientit/instrumentit financiar për secilin nga urdhërat e vendosura nga ai.

#### - Lidhur me ekzekutimin e urdhrave për llogari të klientëve:

- a) Merr nga klienti urdhërat dhe ekzekuton në bazë të parimit të ekzekutimit më të mirë në tregun vendas ose ndërkombëtar OTC.

- **Për Titujt e emetuar nga Qeveria Shqiptare shlyerja e transaksioneve** realizohet përmes sistemit **AFISAR**
- **Për Titujt e huaj: shlyerja e transaksioneve** realizohet përmes platformës **RBI GIG**

### 5. Parimet e përgjithshme të Ekzekutimit më të mirë/best execution

Në përputhje me Nenin 42 të Rregullores nr. 16/2023 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Union Bank, në ekzekutimin e urdhrave të klientëve, merr në konsideratë një sërë faktorësh ekzekutimi me qëllim sigurimin e rezultatit më të mirë të mundshëm për klientin.

#### 5.1 Faktorët kryesorë të ekzekutimit janë:

- c) a) çmimi i instrumentit financiar;
- d) b) kostot e lidhura me ekzekutimin e urdhrit, përfshirë, sipas rastit, kostot e konvertimit valutor;
- e) c) shpejtësia e ekzekutimit;
- f) d) probabiliteti i ekzekutimit dhe i shlyerjes;
- g) e) madhësia e urdhrit;
- h) f) natyra dhe karakteristikat e urdhrit;
- i) g) çdo faktor tjetër i rëndësishëm që lidhet me ekzekutimin e urdhrit.

Rëndësia relative e faktorëve të ekzekutimit përcaktohet në varësi të:

- a) kategorisë së klientit (jo-profesionist ose profesionist);
- b) klasës së instrumentit financiar;
- c) kushteve mbizotëruese të tregut në momentin e ekzekutimit të urdhrit.

## 5.2 Matrica e Faktorëve të Ekzekutimit për Titujt Qeveritarë

Për ekzekutimin e urdhrave për tituj qeveritarë, Shoqëria zbaton matricën e mëposhtme të faktorëve të ekzekutimit, e cila pasqyron rëndësinë relative të secilit faktor sipas kategorisë së klientit dhe monedhës së emetimit të titullit:

**Tabela – Matrica e Faktorëve të Ekzekutimit**

Kategoria e Klientit	Klasa e Instrumentit	Çmimi	Kostot	Probabiliteti i ekzekutimit & shlyerjes	Shpejtësia	Madhësia	Natyra e urdhrit
Jo-profesionist	Tituj qeveritarë në LEK	40%	25%	15%	10%	5%	5%
Profesionist	Tituj qeveritarë në LEK	35%	10%	25%	20%	5%	5%
Jo-profesionist	Tituj qeveritarë në monedhë të huaj	35%	25% (përfshirë FX)	20%	10%	5%	5%
Profesionist	Tituj qeveritarë në monedhë të huaj	30%	10% (përfshirë FX)	25%	25%	5%	5%

- Për klientët jo-profesionistë, Banka i jep rëndësi më të madhe çmimit dhe kostove, si elementë përbërës të rezultatit më të mirë total.
- Për klientët profesionistë, Banka mund të marrë në konsideratë në mënyrë më të balancuar faktorë të tjerë, si shpejtësia dhe probabiliteti i ekzekutimit dhe shlyerjes, në varësi të karakteristikave të urdhrit.

Nëse një klient dëshiron që Union Bank të ndjek udhëzime të veçanta për ekzekutimin e urdhrit të tij, udhëzime që mund ta pengojnë Union Bank në kryerjen e hapave për zbatimin e parimit të “best execution”, kjo e fundit rezervon të drejtën të refuzojë një urdhrë të tillë në rast dyshimi për ekzekutimin më të mirë të mundshëm të tij. Union Bank do të informojë klientin për çdo refuzim të tillë.

Union Bank do të ofrojë për klientët e saj tipologjitë e mëposhtme të urdhërave:

- Urdhër tregu
- Urdhër kufi
- Urdhër specifik

**Në një urdhrë tregu**, klienti dëshiron të blejë ose shesë një titull të veçantë menjëherë me çmimin mbizotërues të tregut. Në këtë lloj porosie, çmimi është faktori më i rëndësishëm për ekzekutimin sa më të mirë. Faktori i dytë më i rëndësishëm për ekzekutimin më të mirë është shpejtësia e ekzekutimit të urdhrit së tregut nga Union Bank. Probabiliteti i ekzekutimit dhe madhësia e urdhrit janë faktorët e tretë më të rëndësishëm për ekzekutimin sa më të mirë.

Me një **urdhër me limit**, klienti dëshiron të blejë ose shesë një titull të veçantë me një çmim fiks. Në këtë lloj porosie, çmimi është faktori më i rëndësishëm për ekzekutimin sa më të mirë të mundshëm. Probabiliteti i ekzekutimit dhe madhësia e urdhrit janë faktorët vijues më të rëndësishëm për ekzekutimin më të mirë.

Me një **urdhër specifik**, Union Bank mund të ekzekutojë urdhërat e klientëve edhe nëpërmjet ofrimit të shitblerjes së titujve nga portofoli i saj në rastin kur klienti është njohur nëpërmjet kanaleve të komunikimit zyrtar të Bankës listën e instrumentale financiare dhe shpreh vullnetin të shesë apo blejë këto instrumenta.

Arsyet për këtë janë:

- Union Bank mund t'u ofrojë klientëve tituj specifike (p.sh. tituj të borxhit të varur, ose tituj të tjerë të Qeverisë Shqiptare) që nuk tregtohen në një treg të rregulluar ose vend tregtimi.
- Klientët zakonisht i drejtojnë kërkesat dhe urdhërat e tyre për kuotime në banka të ndryshme, kështu që ata vetë mund të monitorojnë cilësinë e ekzekutimit të kërkesave dhe urdhrave të tyre.
- Një arsye tjetër për ekzekutimin e kërkesave dhe urdhrave nga klientët nga portofoli i titujve të vete Union Bank është se ajo është një eksperte e dëshmuar në këto instrumente financiare.
  - o Si eksperte, Union Bank ka njohuritë e nevojshme komerciale dhe teknike për të ekzekutuar në mënyrë të besueshme porositë e klientëve për instrumente të tilla. Prandaj, probabiliteti i ekzekutimit të një porosie të klientit është shumë i lartë.
  - o Meqenëse nuk është e nevojshme të kontaktohet një palë të tretë për ekzekutimin e transaksionit të kërkuar, koha midis pranimit të transaksionit nga klienti dhe ekzekutimit të saj nga Union Bank është minimale
  - o Për më tepër, Union Bank mund të mbajë kostot e ekzekutimit sa më të ulëta të jetë e mundur për klientin duke ekzekutuar urdhërat për llogari të tij nga portofoli i vet. Lidhja me një treg përfshin investime fillestare dhe kosto. Për më tepër, tregjet marrin tarifa për çdo transaksion të vendosur përmes tyre, të cilat evitohen në rast të ekzekutimit nëpërmjet portofolit të bankës. Gjithashtu, për tituj ku Union Bank është market maker, ajo nuk u ngarkon tarifa klientëve kur kryen shitblerje nga portofoli i saj i titujve.

Kur ekzekuton një porosi të klientit nga librat e vetë, Union Bank hyn në një marrëdhënie kontraktuale me klientin. Kjo rezulton në ndërmarrjen e një risku reciprok kundër palë dhe performancë.

Në rast mungesë kuotimesh, Union Bank e konsideron të kryer procesin e ekzekutimit më të mirë dhe i ofron klientit një kuotim për shitje të titullit tek ky i fundit bazuar në parimet e paraqitura me sipër.

### 5.3. Devijime dhe Rishikim i Matricës

Banka mund të devijojë nga rëndësia relative e faktorëve të përcaktuar në matricë vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur kjo është e nevojshme për të siguruar rezultatin më të mirë të mundshëm për klientin, duke dokumentuar në mënyrë të përshtatshme arsyet e këtij devijimi.

Matrica e faktorëve të ekzekutimit rishikohet të paktën një herë në vit ose sa herë që ndodh një ndryshim material që ndikon në parametrat e ekzekutimit, në përputhje me Nenin 42, pika 3 e Rregullores nr. 16/2023 të AMF-së.

## 6. Urdhërat e Klientëve/Kërkesa për kuotim

Metoda kryesore për tregtimin e instrumenteve financiare për klientët është metoda e kërkesës së çmimit (Kërkesë për Kuotim ose KpK).

### 6.1 Kërkesa për kuotim (KpK)

Në metodën KpK, klienti kontakton Bankën duke kërkuar një çmim ose kuotim për instrumentin që kërkon të blejë ose shesë. Këto kërkesa mund të kryhen nëpërmjet paraqitjes në degët e Bankës dhe plotësimin të formularëve përkatës të urdhërave ose dërgimit të një emaili ku parashtrohen kërkesat për titullin që dëshiron të shes apo të blej.

Pas marrjes së një KpK nga një klient, Njësia përgjegjëse do të kuotojë Instrumentin në përputhje me parimet e kësaj procedurë dhe do t'i dërgojë klientit “Ofertën e Blerjes ose Shitjes” në mënyrë që Klienti të vendosë më pas të pranojë ose refuzojë këtë ofertë nëpërmjet Urdhër Porosisë.

### 6.2. Metodologjia e çmimeve tek “Kërkesa për Kuotim”

Në varësi të tipologjisë së urdhërit dhe instrumentit financiar të kërkuar Banka me qëllim ruajtjen e një standarti sa më të mirë të parimeve të ekzekutimit më të mirë do të procedojë si me poshtë:

#### **1) Për titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë që përfshijnë;**

- Obligacione të Qeverisë Shqiptare të emtuara për tregun e brendshëm
- Obligacione korporative të emtuara në tregun e brendshëm
- Bono thesari të emtuara nga Qeveria Shqiptare

Do të ndiqet procesi si më poshtë:

- a. Në varësi të kushteve të tregut, Banka përcakton shumën minimale të urdhërit, në varësi të titullit të transferuese, nën të cilës kjo mund të mos pranojë urdhëra nga klienti.
- b. Nëse pas vendosjes së urdhërit për shitje/blerje nga Klienti, Banka nuk ka ose nuk gjen informacion mbi çmimin e titullit në treg, për atë madhësi dhe në kohën kur vendoset urdhëri, dhe Banka e zotëron titullin në portofolin e saj, kjo njësi, mund t'i ofrojë Klientit titullin nga portofoli i Bankës. Në këtë rast konsiderohet se është zbatuar parimi i ekzekutimit më të mirë pasi i është dhënë prioritet shpejtësisë së përmbushjes së urdhërit.
- c. Për qëllime të pikës banka ka si pjesë të politikave të investimit një metodologji të vlerësimit të titujve për rastet që Njësia do të ofrojë këto tituj nga portofoli i Bankës.
- d. Nëse pas vendosjes së urdhërit për blerje ose shitje nga Klienti, nuk ka informacion mbi çmimin e titullit në treg, për atë madhësi dhe në kohën kur vendoset urdhëri, dhe Banka nuk ka interes të veprojë nga

portofoli i saj me klientin, Banka rezervon të drejtën për të mos pranuar transaksionin për shkak të mungesës së informacionit dhe mundësisë për ta ekzekutuar transaksionin në treg.

- e. Për qëllime të pikës d) Banka merr informacion në lidhje me çmimin e tregut nëpërmjet
  - Burime të tjera zyrtare të informacionit mbi çmimet e titujve ose mjete komunikimi të tjera të përdorura nga pjesëmarrësit në treg.
- f. Nëse pas vendosjes së urdhrin për blerje ose shitje nga Klienti, ka informacion dhe mundësi për ta ekzekutuar transaksionin në treg, Banka vendos ta ekzekutojë urdhrin në një nga mënyrat e mëposhtme
  - Ta transmetojë urdhërin, duke e lënë vlefshmërinë e urdhrin sipas kohës që përcaktohet nga klienti, ose sipas gjykimit të Njësisë përgjegjëse.
  - Ta ekzekutojë urdhrin duke vepruar nga portofoli i vet, duke i ofruar një çmim të barabartë ose më të mirë sesa çmimi i tregut.
- g. Informacioni i mësipërm nuk do të konsiderohet nëse çmimi i fundit i përditësuar i tregut nuk është brenda kuadrit kohor të 30 minutave, nga momenti që është vendosur urdhëri nga klienti. Nëse informacioni i ofruar nga platforma të tjera të miratuara tejkalon kuadrin kohor të 30 minutave, do të konsiderohet se informacioni i dhënë nga tregu nuk mund të përdoret për ekzekutimin e urdhrin, dhe Banka do të veprojë sipas shkronjave a, b dhe c.

## 2) Për titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë që përfshijnë, në parim:

- a. Eurobonde të emetuara nga Qeveria Shqiptare;
- b. Obligacione Qeveritare të emetuara në tregun e jashtëm;
- c. Obligacione korporative të emetuara në tregun e jashtëm;
- d. Bono thesari të emetuara nga Qeveri të huaja;

Do të ndiqet procesi si më poshtë:

- Kontrollon në Factset/Cbonds/LSEG ose platforma të ngjashme informacion mbi çmimet e indikative të titullit objekt i urdhrin të klientit;
- Kërkon kuotim për çmimet nga shoqëri komisionere të huaja që punojnë mbi bazën e parimit të ekzekutimit më të mirë/best execution MIFID 2 compliant);

## 7. Radha e Ekzekutimit të Urdhërave

Përparësi në ekzekutimin e urdhërave kanë klientët e bankës. Pas këtij ekzekutimi, Banka mund të ekzekutojë urdhëra në favorin e vet. Në qoftë se janë disa klientë, atyre i shërbehet në bazë të parimit "I shërbehet atij që vjen i pari".

## 8. Transparenca

Në momentin e hyrjes në një transaksion shit/blerjeje të një instrumenti financiar, klienti mund ti kërkojë bankës që ti vërtetojë se ka marrë çmimin më të mirë. Banka në këtë rast është e detyruar të tregojë: Në rastin kur banka bën rolin e ndërmjetësit midis blerësit dhe shitësit, banka tregon komunikimet me brokerat e ndryshëm (minimum 2 brokera)

Në rastin kur shet nga portofoli i vet, banka tregon (nëse ka) kuotimet që kanë kontributorë të ndryshëm për instrumentin financiar që do të tregtohet.

#### 8.1 Parimet e përzgjedhjes së kundër palëve për marrjen dhe transmetimin e urdhërave

Në mënyrë që të arrihen në mënyrë të vazhdueshme rezultatet më të mira të mundshme për klientët në ekzekutimin e urdhërave, banka përzgjedh kundër palë të cilat:

- operojnë në një numër gjithëpërfshirës vendesh ekzekutimi (execution venues) dhe janë të pajisura teknikisht dhe strukturalisht për të siguruar shërbimet e tyre në mënyrë të qëndrueshme dhe me cilësi të lartë. Janë të licencuara si shoqëri komisionere dhe operojnë sipas kushteve MIFID 2.

Banka kryen transaksione me instrumenteve financiare të emetuara ose të tregtuara në tregje ndërkombëtare nëpërmjet RBI Vienna (kujdestar) dhe 2 kompanive të brokerimit SFI Markets dhe AFS Interest (ndërmjetës financiar) të cilët sipas gjykimit të bankës sigurojnë ekzekutimin e urdhërave me cilësi të lartë. Banka rezervon të drejtën për të zgjedhur ndërmjetësin financiar që ajo e konsideron të përshtatshëm.

#### 9. Kostot e ekzekutimit të urdhërit

Të gjitha kostot që lidhen drejtpërdrejt me ekzekutimin e urdhërit , përfshirë tarifat e vendit të tregtimit, tarifat e klerimit dhe shlyerjes dhe tarifat e ndërmjetësit përmes të cilëve Banka ekzekuton urdhrat e klientëve, përfshihen në tarifën përkatëse sipas kushteve të punës së Union Bank. Çdo kosto shtesë si taksat, taksat qeveritare ose rregullatore, ose pagesa të tjera për palët e treta që mund të lindin në lidhje me ekzekutimin e urdhërave të klientit, hyrjen në transaksione, ose ofrimin e shërbimeve të tjera do të mbarten nga klienti.

#### 10. Kategorizimi dhe Përshtatshmëria e klientëve

Banka ka procedure më vete për njohjen, kategorizimin, përshtatshmërinë dhe marrëdhëniet me klientin investues në tregjet e kapitalit, e cila po ashtu zbatohet nga të gjitha strukturat e Bankës, që janë të përfshira në ofrimin e aktiviteteve përkatëse, siç përcaktohet nga ligji 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloret e lidhura me të, të<sup>1</sup> miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

- a) Kategorizon Klientët në përputhje me rregulloren nr. 197, datë 29.12.2020 të AMF-së “Për vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit”
- b) Merr informacionin e nevojshëm për çdo klient ekzistues ose të mundshëm në fushën e investimeve, të dokumentuar nëpërmjet plotësimit nga klienti të pyetësorit standard si dhe ndihmon klientin në plotësimin e testit për vlerësimin e përshtatshmërisë.
- c) Kryen vlerësimin e përshtatshmërisë së klientëve
- d) Kryen njoftimet e klientit që lidhen me vlerësimin e përshtatshmërisë.

---

<sup>1</sup> Rregullore nr.197, date 29.12.2020 “Për vlerësimin e përshtatshmërisë së klientit”

## 10. Modalitetet e Regjistrimit të Urdhërave

Regjistrimet e urdhrave duhet të bëhen në rend kronologjik dhe kryhen menjëherë sapo ato merren nga dega e bankës apo në mënyrë të drejtpërdrejtë nga klienti.

Rendi kronologjik kushtëzon prioritetin në plotësimin e tyre sipas metodës “first come first served basis” përveçse kur karakteristikat e urdhrit ose kushtet mbizotëruese të tregut e bëjnë këtë të perealizueshme, ose jo në interesin më të mirë të klientëve.

Banka mund të bashkojë urdhëra të vendosur nga klientë të ndryshëm kur ato kërkohen të kryhen me të njëjtat kushte dhe në të njëjtën kohë. Në një rast të tillë, Njësia përgjegjëse kujdeset që t’i shpërndajë titujt në mënyrë të drejtë mes klientëve, urdherat e të cilëve janë bashkuar, në përpjesëtim me vlerën e secilit urdhër, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, në varësi nga realizimi i transaksionit në treg.

Regjistrimi i udhërave në librin e urdhërave bëhet i mbështetur në parimin e katër syve duke përfshirë nivelin e inputimit dhe atë të autorizimit.

Në rast të mbajtjes së librit të urdhërave në Excel, duhet që file-i specifik të jetë i mbrojtur dhe i aksesueshëm nëpërmjet një password-i, në mënyrë që të shmangen ndërhyrjet e paautorizuara në këtë libër.

Banka hyn në traksaksione për të përmbushur kërkesat e klientëve të saj me banka dhe brokera, të cilët kanë kaluar procesin e KYC dhe AML. Shlyerja e pagesave bëhet sipas parimit " Shlyerje kundrejt pagesës DVP (Delivery Versus Payment)". Banka kujdeset që procesi i DVP të realizohet në kohë dhe në përputhje me kushtet e rëna dakord për shit/blerjen e instrumentit financiar.

Në qoftë se procesi DVP dështon për arsye të paaftësisë paguese të klientit ose të paaftësisë së gjetjes së instrumentit financiar, Banka me përvojën që ka do të mundohet të zgjidhë këtë ndalesë që të gjitha palët të ngelin të kënaqur.

## 11. Publikimi Vjetor i Vendeve të Ekzekutimit dhe Cilësisë së Ekzekutimit

1. Banka, në përputhje me Nenin 42, pika 7 të Rregullores nr. 16/2023 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, publikon çdo vit, për çdo klasë të instrumenteve financiare, informacion mbi pesë (5) vendet më të mira të tregtimit, përsa i përket vëllimit të tregtimit, tek të cilat ka transmetuar urdhrat e klientëve gjatë vitit kalendarik paraardhës.
2. Informacioni i publikuar përfshin, për secilën klasë të instrumenteve financiare, të paktën elementet e mëposhtme:
  - a) emrin e vendit të tregtimit ose të platformës së ekzekutimit;
  - b) përqindjen e vëllimit total të tregtimit të realizuar në secilin vend;
  - c) ndarjen e vëllimit sipas kategorisë së klientit (jo-profesionist dhe profesionist), sipas rastit;
  - d) ndarjen e urdhrave të ekzekutuar brenda dhe jashtë një tregu të rregulluar, kur është e zbatueshme.
3. Informacioni i parashikuar bëhet publik në një mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme për klientët, përfshirë publikimin në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë, brenda një afati të arsyeshëm pas përfundimit të vitit kalendarik përkatës.
4. Shoqëria ruan dokumentacionin mbështetës për të dhënat e publikuara dhe është në gjendje t’ia paraqesë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me kërkesë të këtij të fundit.